


# DEMOKRACIA



# ËSHTË PAQË

## INSTITUCIONI LIGJVËNËS

BLERTON (14), ANDI (14), VIOLAND (13), LINDOR (14), JEHONA (14), SYAR (13), ARENA (13)



### Të dashur lexues, sot nga ne do të mësoni për institucionin ligjvënës të Kosovës, i cili është Kuvendi

Kuvendi i Kosovës udhëhiqet nga Kryetari i Kuvendit. Në Kuvend marrin pjesë gjithsej 120 deputetë. Nga ta 100 janë shqiptarë shumicë, kurse 20 janë të komuniteteve të tjera, që jetojnë në Kosovë dhe që ne iu referohemi si komunitete jo shumicë. Këta deputetë zgjedhen nga populli dhe e përfaqësojnë popullin në Kuvend, duke propozuar ligje të ndryshme në të mirë të popullit. Ligjet në Kuvend, njëherë shkojnë si projektligje, ku më pas deputetët votojnë dhe mendojnë mirë se a janë këto ligje në të mirë të popullit apo në të mirë të interesave personale të personit që i ka propozuar ato ligje. Që të miratohet një ligj duhet të votojnë pro më shumë se 50% të deputetëve. Nga këto ligje, përfituesit më të mëdhenj janë qytetarët të cilët iu kanë besuar votat deputetëve. Mandati i një deputeti

zgjat 4 vjet, kurse mandati i një Presidenti zgjat 5 vjet. Kuvendi ka tri funksione kryesore: funksionin përfaqësues, funksionin legjislativ dhe funksionin kontrollues. Pra, Kuvendi ushtron edhe funksionin kontrollues, që i bie se kontrollon punën e Qeverisë, e cila bën zbatimin e ligjeve të marra në Kuvend. Arsyeja pse ne mendojmë se Kuvendi është kaq i rëndësishëm për ne është se ai miraton ligje, të cilat ne i hasim në çdo ditë të jetës sonë. Si për shembull, ligji mbi arsimimin mundëson neve të kemi kushte më të mira shkolimi dhe hapje të shkollave të reja. Pra, Kuvendi është shumë i rëndësishëm për vendin tonë, mirëpo edhe roli i qytetarit është shumë i rëndësishëm për shkak se një votë e tij mund ta ndryshoj qeverisjen. Të gjithë ne jemi shumë të rëndësishëm. Ne ju ftojmë që të jeni aktiv dhe të përkushtuar ndaj shtetit tuaj, sepse vetëm me punë dhe duke i zbatuar elementet e demokracisë do të mund ta bëjmë shtetin tonë edhe më të zhvilluar.




Të gjithë jemi të barabartë



Ne e përkrahim zhvillimin e vendit

## NE ZGJEDHIM, NE VENDOSIM

BLERON (14), BLEND (14), ARBENITA (15), AGNESA (13), BRIKENA (14), ERILON (14), ELDA (14)



Vota jote është mendimi yt. Shprehe atë në demokraci. Kurrë mos e harro se e ardhmja e të gjithë neve ndryshon me votat tona të lira!

### Ky artikull flet për zgjedhjet dhe llojet e zgjedhjeve në Kosovë, si dhe rëndësinë e votës

Procesi më i rëndësishëm që ndodh në vendet demokratike është procesi zgjedhor. A e dini pse? Sepse në këtë proces, ne populli i zgjedhim përfaqësuesit tanë. Këta përfaqësues kanë për detyrë të udhëheqin vendin tonë. Me vendimet që i marrin, ata mund ta ngrisin lart vendin tonë, apo ta ulin poshtë. Kjo sepse ata marrin vendime të ndryshme në emrin tonë. Procesi zgjedhor ndodh çdo 4 vjet. Kjo ndryshe njihet si mandati 4 vjeçar i përfaqësuesve.

Çdo njeri ka të drejtën e votës. Mirëpo, këtë të drejtë e shfrytëzojmë pasi të mbushim moshën 18 vjeçare. Ne mendojmë se kjo është e drejtë, pasi në këtë moshë njeriu hyn në moshën e pjekurisë dhe mund të marrë vendim se kush e meriton votën e tij. Secili njeri duhet t'i ketë të drejtat e barabarta. Kjo vlen edhe për zgjedhje. Kjo nënkupton se pa dallim feje, gjinie, apo gjendje ekonomike, ne kemi të drejtën e votës. Ne duhet të jemi të gatshëm dhe të lirë të votojmë më të mirin për vendin tonë.

Gjatë diskutimit në grup, ne e kuptuam se kur të jemi në moshën 18 vjeçare, duhet të dalim të votojmë në mënyrë që vota jonë të bëj patjetër ndryshimin. Në qoftë se ne nuk dalim të votojmë, atëherë mund të ndodh që në krye të vendit, të vijë ai i cili nuk duhet. Vota duhet të jetë individuale dhe ne nuk duhet ta lëmë askënd që të na bind të ndryshojmë mendim rreth kësaj.

Kemi dy lloje të zgjedhjeve në Kosovë: zgjedhjet komunale dhe ato parlamentare. Në zgjedhjet komunale ne votojmë për kryetarin e komunës. Këtë kandidat, ne e mendojmë paraprakisht se a i plotëson kushtet për të qenë kryetar i komunës përkatëse. Kurse, në zgjedhjet parlamentare populli i zgjedh përfaqësuesit e vet në Kuvend, të cilët janë deputetët.

Ndërsa, deputetët janë ata të cilët e votojnë dhe e zgjedhin Presidentin e vendit tonë. Nëse një shoku ynë në të ardhmen nuk do të dëshironte të merrte pjesë në procesin zgjedhor, atëherë ne do ta bindim që ai apo ajo të dal në zgjedhje, me këto këshilla: nëse ti voton atëherë do të kesh një të ardhme më të mirë, sepse do të votosh më të mirin. Ti je i/e lirë të shprehësh mendimin tënd. Vota është mendimi yt personal, prandaj shprehe atë dhe mos hezit.



Autorët e artikullit

## JETA NË DEMOKRACI

ELMEDINA (14), ARTI (13), ALBIN (14), LEON (13), BLERTINA (14), ELIAN (14), BESMIR (14)

**A keni menduar ndonjëherë për demokracinë dhe se si mund të ndikojmë ne në një vend demokratik? Nëse po, lexojeni këtë artikull**

Liria është fjalë me domethënie të madhe, që mund ta shprehim në mënyra të ndryshme. Pra, ne jemi shumë me fat që e kemi lirinë tonë të cilën na mundëson demokracia. Liria është gjithçka për ne. Të drejtat e njeriut përfshihen pikërisht në demokraci.

Këto të drejta i takojnë njeriut nga lindja e deri në vdekje. Në kohët e hershme të drejtat iu takonin vetëm burrave të pasur, por me kalimin e kohës shtete të ndryshme në mbarë botën, miratuan të drejtat e grave pastaj dhe të fëmijëve.

Ne jemi pjesë e demokracisë ku mendimet dhe puna jonë vlejnë. Pra, demokracia është formë e qeverisjes që mbron të drejtat e njeriut.



Puna në grup



A mund të më tregosh se çfarë është demokracia?

Elmedina duke pyetur Albinin për demokracinë



Demokracia do të thotë udhëheqje e popullit

Albini i përgjigjet pyetjes




Elian, çfarë je duke bërë?

Interesimi i Bismirit për punën e shokut



Jam duke shkruar për disa nga elementet e demokracisë

Eliani tregon se çfarë po shkruan




### Kuptimi i fjalës demokraci


Fjala demokraci rrjedh nga gjuha greke. Pra, „demos“ që do të thotë popull dhe „kratia“ udhëheqje. Dallojmë dy lloje të demokracisë: demokracia e drejtpërdrejtë dhe demokracia përfaqësuese. Në demokracinë përfaqësuese janë dy sisteme: sistemi parlamentar dhe ai presidencial. Ne jetojmë në një vend demokratik me sistem parlamentar, ku populli në procesin zgjedhor voton kandidatët për deputetë. Akti më i lartë juridik i një vendi demokratik është Kushtetuta. Në Kushtetutën e Republikës së Kosovës janë gjithsej 162 nene. Disa prej tyre janë: e drejta për jetën, liria e lëvizjes, barazia para ligjit, e drejta e lirisë dhe sigurisë, mbrojtja shëndetësore dhe sociale, etj. Ne duhet të jemi të vetëdijshëm për gjërat që i bëjmë në ditën e sotme, sepse gjithmonë do të gjendet një laps që ta shkruajmë të ardhmen, por asnjëherë nuk mund të gjendet një gomë që ta fshijmë të kaluarën.




Gazetarët e artikullit



Liria, e drejta themelore e njeriut



Barazia në demokraci



## IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI  
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA  
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



**ERSTE Stiftung**

Redaktohet nga  
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit  
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga  
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë:  
Tel: +381 38 704 560  
E-mail: [info@demos-ti.org](mailto:info@demos-ti.org)  
Website: [www.demos-ti.org](http://www.demos-ti.org)

Pjesëmarrësit:  
SHFMU „Halil Alidema“  
Klasa: VIII-1  
Vendi: Pozhoran, Viti